V E N D I M
Nr.580, datë 2.9.1996

PËR NDRYSHIMIN E PAGËS MESATARE PËR EFEKT KONTROLLI

Me propozimin e Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.345, datë 10.8.1992 "Për shpërblimin e punës së punonjësve", të bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 3 paragrafi i parë zëvendësohet me këtë përmbajtje: "Paga mesatare mujore për efekt kontrolli, sipas ministrive dhe institucioneve të tjera qendrore për ndërmarrjet shtetërore dhe institucionet shtetërore jobuxhetore e pjesërisht jobuxhetore, si dhe për shoqëritë aksionare me kapital tërësisht shtetëror të sistemit të tyre, është sipas listës që i bashkëlidhet këtij vendimi."

2. Pas pikës 8 shtohet pika 8/1 me këtë përmbajtje: "Për shoqëritë aksionare me kapital tërësisht shtetëror pagat e drejtorëve caktohen nga organi që ka në kompetencë emërimin e tyre. Për shoqëritë aksionare me deri 200 punonjës paga e drejtorit të jetë deri në nivelin e pagës së shefit të sektorit në ministri, kurse për ato me mbi 200 punonjës deri në nivelin e pagës së drejtorit të drejtorisë në ministri (përfshirë edhe shtesat mbi pagë). Për drejtorët e bashkësive ekonomike, të Telekomit dhe AMC-së deri në nivelin e pagës së zëvendësministrit.

Për punonjësit e këtyre shoqërive masa e shpërblimit suplementar është jo më shumë se dy paga mujore në vit për secilin.

Këto nivele page rekomandohen të zbatohen edhe për shoqëritë aksionare me kapital shtetëror mbi 50 për qind.

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë. Për punonjësit që kanë pagë nën 4400 lekë në muaj efektet financiare fillojnë nga data 1 prill 1996."

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi

PAGA MESATARE MUJORE PËR EFEKT SIPAS MINISTRIVE DHE INSTITUCIONEVE TË TJERA QENDRORE PËR PUNONJËSIT E NDËRMARRJEVE E INSTITUCIONEVE JOBUXHETORE DHE TË SHOQËRIVE AKSIONARE

Nr.	Emërtimi	Paga mesatare mujore në lekë
1.	Ministria e Burimeve Minerare dhe Energjetike	6000
2.	Ministria e Punëve Publike, Rregullimit të Territorit dhe Turizmit	5050
3.	Ministria e Industrisë, Transportit dhe Tregtisë	4950
4.	Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit	5500
5.	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Gruas	4600
6.	Ministria e Shëndetësisë dhe Ambientit	4900
7.	Ministria e Brendshme	4750
8.	Ministria e Arsimit dhe Sporteve	4600
9.	Ministria e Mbrojtjes	4950
10.	Ministria e Punëve të Jashtme	5300
11.	Ministria e Financave (për shtypshkronjën e letrave me vlerë)	5170
12.	Departamenti Shtetëror i Postave dhe Telekomunikacionit	4750
13.	Drejtoria e Informatikës Ekonomike	4670
14.	Drejtoria e Shërbimit Qeveritar	6160
15.	Agjencia e Ristrukturimit të Ndërmarrjeve	5900